

## NJOFTIM

Qendra e Personel Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes kërkon të rekrutojë kandidatë për ushtar/detar aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

QPR ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtar/detarë aktivë.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në **19 dhjetor 2016**

### **Kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktiv**

**a).** Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- ◆ Të jetë shtetas shqiptar.
- ◆ Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale.
- ◆ Të mos jetë në ndjekje penale.
- ◆ Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykatë.
- ◆ Të mos jetë në proces gjykimi penal nga Gjykata
- ◆ Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përfundimisht bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç
- ◆ Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit.
- ◆ Të ketë kaluar testin, fizik, intelektual dhe psikologjik.
- ◆ Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat.
- ◆ Kandidatët për ushtar, të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake, duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe femrat.

**b).** Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kriterëve të aplikohen edhe kriteret specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv.

a). Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.

b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.

c) Proçedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.